



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovac



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), e mbajtur më 12.11.2024, me fillim në orën 10:15. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, z. Arbër Zenuni.

Kryesuesi: Fillimisht, përvendetje për të gjithë! Inderuar nënkyetar i komunës, z. Fatmir Iska, të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtore të drejtoreve, zyrtarë komunalë, përfaqësues të OSBE-së, të gjithë ju të pranishëm. E hapim mbledhjen e njëmbëdhjetë (11) të Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2024. Në konsultim me kryetarin e komunës kemi përgatitur këtë rend dite;

R E N D D I T

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për caktimin e normave tativore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2025;**
- 3. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndarje të parcelave në ZK- Kramovik P- 00760-1 dhe ZK Petkoviq (Gur i Kuq) P-00185-0, 0122-0, 01124-2, 001124-0;**
- 4. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpallje të interesit të përgjithshëm të parcelave kadastrale ZK- Kramovik dhe Petkoviq (Gur i Kuq);**
- 5. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale, P- 00268-1 ZK-Hoçë e Madhe;**
- 6. Të ndryshme.**

Shtesë:

- 7. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, P- 002681, zk- Hoçë e Madhe;**
- 8. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr. 253/24, i datës 24.09.2024 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale.**

Kryesuesi: Atëherë, ky është rendi i ditës për sot, me dy pika shtesë (7,8). Nëse nuk ka dikush diçka, e vendosim në votim. Kush është “për”... Kundër... Konstatoj që unanimisht (6 vota) votohet rendi i ditës.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryesuesi: A ka dikush ndonjë sugjerim apo vërejtje rreth procesverbalit? Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është “për”... Kundër... Me 6 vota “për” aprovohet pika e parë.

2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për caktimin e normave tativore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2025;

Afrim Limani: Inderuar nënkyetar, të nderuar anëtarë të KPF-së. Sipas ligjit Nr. 06 L/005 për tatimin në pronën e paluajtshme, kuvendet komunale duhet që një herë në vit dalin me propozime për normën tativore. Si komunë kemi vendosur që normat tativore në parcelat bujqësore, për njësitet bujqësore të objekteve dhe për njësitet pyjore të parcelave të shkojmë me një propozim nga 16 deri në 10%, që sipas ligjit ky është kufiri më i ulët. Në parcelat bujqësore futen këto: Arat bujqësore, vreshat, pemishtet, kullosat, livadhet, pronat pyjore dhe pronat pyjore-malore. Sipas një analize që e kemi bërë, ndikimi në vlerë nëse shkojmë me normën 10% është 329.000€ dhe 98% të pronave i përkasin kësaj normë tativore.

Leonard Morina: Faleminderit kryesues! Përshëndetje për nënkyetarin, drejtorët, anëtarët e KPF-së. Drejtor, cila është arsyja që po e bëni këtë zbritje? A është përfushatë, a po e keni bërë një analizë paraprake pse pikërisht në këto tri kategorit?

Burim Krasniqi: Drejtor, mendoj që është mirë që në seancë të kemi vendimin dhe tarifën e vitit 2024 dhe këto që po propozohen tanë, që ne si asambleistë t'i krahasojmë. E dyta, 0.16% nuk është minimum, por, 0.10% është minimumi i normës tatimore. Duke pasur parasysh plotësim-ndryshimin e ligjit 06 L/005, të cili e ka bërë ligji Nr. 08L/224 janë të dhëna vlerat e detyrimit tatimor dhe llogaritet sipas kufijve. Mbi 100.000 – 500.000, deri në 1 milion dhe deri në 5 milionë. Këto vlera, a shkojnë për parcelë, apo për titullar? Besoj që dallojnë shumë në mes veti, sepse një pronar mund t'i ketë 2-3 parcela të ndryshme dhe asnjëra parcelë mos të kalojë vlerën 100.000€ dhe të tatimohet sipas pikës 3.1 dhe në qoftëse parcelat grumbullohen, mund t'i tatimohen sipas pikës 3.3. Tjetra, e kemi biseduar edhe në seancën e vitit të kaluar kur ka ardhur vendimi për normat tatimore për tokat bujqësore. Meqenëse është bërë vlerësimi i pronave, sa është sfidues implementimi i ligjit? Duke pasur parasysh që ka prona që nuk janë të trashëguara te pronari faktik, ose ekzistojnë nëpër pronarë të cilët e kanë pasur pronën paraprakisht. Një prej rasteve që e njoh mirë, është rasti i Krushës së Madhe që pëershakatë komosacionit, tokat në Krushë të Madhe janë krejt ndryshe, të pabartura te trashëgimtarët dhe ka shitblerje që nuk janë bartur te blerësit. A do të jetë problem, nëse fillon së zbatuari dhe a e keni për obligim që patjetër ta zbatoni këtë? Çka ndodh kur i shkon tatim pronarit që juridikisht është pronar, por faktikisht jo?

Afrim Limani: Leonard, ne kemi vendosur që ta zbresim normën tatimore në parcelat bujqësore, si rezultat i asaj që dëshirojmë t'i ndihmojmë bujqve, sepse e meritojnë. Burimi i bëri disa pyetje. Te plotësim-ndryshimi i ligjit imbi tatimin në pronë 06L/005, neni 9. Në fillim e përmenda që te neni 9, pika 3.1 për vlerën e pronës deri në 100.000€ aplikohet shkalla tatimore që mund të varion nga 0.10% deri në 1%. Aktualisht e kemi 0.16% dhe ne jemi duke propozuar që ta zbresim deri te kufiri më i ulët që është 0.10%.

Burim Krasniqi: Në propozim-vendim është gabim, 10% shkruan dhe jo 0.10%.

Afrim Limani: Atëherë, është një gabim teknik, sepse është 0.10%. Te pika 3.2 për vlerën e pronave mbi 100.000€ aplikohet shkalla tatimore që mund të variojë nga 0.20% deri në 1%, sipas programit. Ju thash që, përafërisht në komunën tonë rreth 98% të pronave i përkasin pikës 3.1 (nga 0.10%-1%).

Burim Krasniqi: Mund të jetë një pronë që i takon pikës 3.1, a llogariten pronat “veç a veç”, apo i llogaritet një pronari?

Afrim Limani: Është fjalë për prona që lidhen me një pronar.

Burim Krasniqi: Nëse pronari i ka tri prona të pikës 3.1, kalon në pikën 3.3.

Afrim Limani: Sipas ligjit 30% e vlerës minusohet dhe nuk tatohet. Sipas një analize, ndikimi në vlerë është 329.000€, d.m.th zbritja nga 16% në 10%. Tokat me vlerë 100.000-500.000 janë 166 prona me normë 20% dhe në vlerën 58.365. Tokat me vlerë 500.000-1.000.000 janë 5 prona dhe tatohen me 30% dhe në vlerë është 8135€. Tokat e vlerësuara nga 1 milion deri në 5 milionë janë nëntë prona që tatohen me 40% dhe vlera është 62.470€. Arë bujqësore i kemi 21.430 ha, vreshta 4443 ha, pemishte 275 ha, kulla 3205 ha, livadhe 1178 ha, prona pyjore 6543 ha dhe prona pyjore-malore 1 ha. Të gjitha këto janë të llogaritura sipas sistemit të Agjencionit Kadastral të Kosovës. E kam edhe një shembull, te vlerësimi i arave: Supozojmë që e kemi 1 ha, çmimi për m^2 është 5€, që i bie 50.000€, shumëzohet me herë 0.16% del çmimi që duhet të paguhet është 80€ dhe me këtë propozim përvitin 2025 çmimi i kësaj prone bëhet 50€. Kjo është zona e parë dhe njihet si zonë me çmim më të lartë.

Burim Krasniqi: Gjithmonë filloj prej ligjit mbi plotësim-ndryshimin e ligjit, te nenii 9, paragrafi 3.2 përpos vlerës që është 0.2-1%, thotë plus nga nënparagrafi 3.1. Paragrafi 3.3 e jep vlerën 0.3-1% dhe thotë plus, nënparagrafi 3.1 dhe 3.2, a nënkupton kjo që dy herë apo tri tatimohet prona, varësisht prej vlerës? Dicëtë, te propozim-vendimi, te tebela e parë janë normat tatimore që bazohen në pikën 3.1 që është 0.1-1%, por nëse kalojmë te pika 3.2, 3.3, 3.4, 3.5, në tabelë nuk kemi normë tatimore. Nëse prona kalon vlerën 100.000€ nuk mund të tatimohet me 0.12 apo 0.19, por duhet të shkojmë mbi 0.20%. Nuk është e specifikuar në tabelën e propozim-vendimit. Sa është norma tatimore e një prone me vlerë 120.000€? 0.2 apo 1%?

Afrim Limani: Këto tatohen sipas sistemit Protax, gjenerohen me sistem.

Burim Krasniqi: Kryesues, ju kërkoj falje për këtë formë interaktive. Pika 3.2 thotë: Për vlerën e pronave mbi 100.000€ aplikohet shkalla tatimore që mund të variojë prej 0.2 deri në 1%, plus nga nënparagrafi 3.1. Konsideroj që në propozim-vendim duhet të jetë tabela edhe sipas pikës 3.2 dhe sipas pikës 3.3, 3.4 dhe 3.5, që

minimumin e ka 0.5% dhe maksimumin 1. Në asamble komunale duhet ta përcaktojmë me vendim normën tatimore se a do të jetë 0.5%, apo 0.51 etj... Në këtë format siç është në propozim-vendim për pronat me vlerë mbi 100.000, mbi 500.000, mbi 1 milion dhe mbi 5 milionë, nuk kemi normë të përcaktuar saktësisht.

Afrim Limani: Nëse do të më kuptoje më mirë, ndoshta nuk do t'i bëje këto pyeje. Kërkoj falje! Plotësim-ndryshimi i ligjit të tatimit në pronë, përkatësisht neni 9, te pika 3.1 vlera e pronës deri në 100.000€ ne i caktojmë përmes kuvendeve komunale normën tatimore. Te pika 3.2, vlera e pronave mbi 100.000€ aplikohet shkalla tatimore që mund të variojë 0.20% deri në 1%, plus tatimi nga nënparagafi 3.1. Në këtë rast vlera e pronave që e kalon 100.000€ gjenerohet nga sistemi në mënyrë të drejtpërdrejt për normën tatimore dhe i shtohet edhe tatimi nga paragafi 3.1. Në bazë analizave unë i kam përcaktuar edhe sa prona janë dhe sa është ndikimi në vlerë.

Burim Krasniqi: Diskutimin dëshiroj ta lidhi në raport me pyetjen e Leonardit dhe arsyetimin e drejtorit. Tatimi në tokë, duke iu referuar raportit financiar janar-qershori është zero zero.

Afrim Limani: Nuk është e vërtetë!

Burim Krasniqi: Në raportin tuaj thotë që planifikimi i tatimit në tokë është 276.704€.

Afrim Limani: Këto janë të hyrat në total të tatimit në pronë. Nuk kemi pasur mundësi t'i ndajmë nga tatimi në tokë. Unë i kam të dhënët.

Burim Krasniqi: Kur thua “nuk është e vërtetë”, i bie që unë po “rrej”. Unë jam duke e lexuar raportin tënd dhe nëse ti na ke mashtruar në raport, nuk është në rregull. Kodi 40110 tatimi në tokë, planifikimi për 2024 është 276.704€, realizimi është zero zero. Ulja e vlerës së tatimit në tokë e kanë ulur veç për t'u dukur “hijshëm” sepse nuk ka ndonjë efekt.

Afrim Limani: Ky është konstatim i juaji! Kur e kam prezantuar raportin 9-mujor financiar i kam përbledhur të hyrat në total të tatimit në pronë, bashkë me tatimin në tokë dhe në objekte, sepse nuk jemi pasur mundësi ta bëjmë klasifikimin. Në fund do ta kesh raportin përfundimtar financiar.

Burim Krasniqi: Dëgjo drejtor, ky stili më thënë që “nuk është e vërtetë”, që i bie “po rren” është e rëndë. Kjo shprehje nuk duhet të ekzistojë në etikën e askujt këtu.

Afrim Limani: Dëgjo, këshilla nuk ke nevoj të më japësh, sepse unë di më mirë dhe e kam një përvojë goxha të gjatë këtu. Ti the që të hyrat e tatimit në tokë janë zero. Të thash që nuk është e vërtetë dhe ashtu është, por, e pranoj që nuk kemi arritur t'i klasifikojmë.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! Nëse nuk kemi pyetje tjera, e vendosim pikën në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë, me 5 vota pro, 1 kundër dhe asnje abstenim miratohet pika e dytë.

3. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndarje të parcelave në ZK- Kramovik P- 00760-1 dhe ZK Petkoviq (Gur i Kuq), P-00185-0, 0122-0, 01124-2, 001124-0:

Afrim Oruqi: Faleminderit kryesues! I nderuar nënkyetar, kolegë drejtorë, të nderuar anëtarë të KPF-së. Me kërkësë të Ministrisë së Ekonomisë, që i ka në shfrytëzim këto parcela ku po ndërtohet parku solar. Sipas ligjit kërkohet që fillimisht t'i ndajmë parcelet dhe tutje t'i këmbejmë me Ministrinë e Ekonomisë, që ta pastrojme terrenin për të filluar së implementuar projektin nga shkurti i vitit të ardhshëm. Parcelat janë në dy zona, në Petkoviç dhe në Kramovik. Ju ftoj që ta votoni propozimin për ndarjen e parcelave, duke mos e ndërruar destinimin e pronarit.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! Nëse nuk kemi pyetje tjera, e vendosim pikën në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë, me 5 vota pro, miratohet pika e tretë.

4. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpallje të interesit të përgjithshëm të parcelave kadastrale ZK-Kramovik dhe Petkoviq (Gur i Kuq):

Afrim Oruqi: Kërkoj mirëkuptimin e anëtarëve të KPF-së për shkak të mungesës së materialit, sepse nuk e kemi as ne. Këtë proces po e zhvillon Ministria e Ekonomisë dhe jemi duke pritur që ta kemi një studim të detajuar se për cilat parcela bëhet fjalë. Dihet saktë për zonat, por jo saktësisht sa është sipërsfaqja e këtyre parcelave të Ministrisë së Ekonomisë, e cila i ka në shfrytëzim. Tutje, në seancat e radhës duhet t'i këmbejmë këto parcela me parcela të komunës. Në parim, ju ftoj që ta votoni edhe këtë propozim që mos të hiumbin kohë, sepse ata janë vonë dhe deri në shkurt të vitit të ardhshëm duhet ta përfundojmë këtë punë.

Burim Krasniqi: Drejtor, pika e katërt ashtu siç është, është e padefinuar e the edhe vetë! Nuk dihet se cila parcelë po shpallet interes i përgjithshëm. Nëse nuk vjen materiali për seancën e radhës, a nënkupton që duhet të tërhoqet kjo pikë nga rendi i ditës? A është mirë që kjo pikë të vie direkt në asamble komunale, pa e votuar sot në

KPF dhe ta vendosim si pikë shtesë? Më mirë kështu, se sa ta votojmë sot, ta tërheqim në seancë, apo të votojmë diçka pa material. Propozoj që kjo pikë mos të kalojë tutje, sepse është diçka që nuk varet nga komuna, por nga një institucion tjeter.

Afrim Oruqi: Asambleisti e ka arsyeshëm këtë çështje. Saktësisht, ne e dimë se për cilat parcela bëhet fjalë, në këtë rast ju nuk e dini dhe kjo është pa fajin tonë. Me sekretariatin e kuvendit, shumë shpejt do të kujdesemi që ta bëjmë materialin për kuvend. Jemi takuar me ta dhe e kemi një orientim, por mund ta procedojmë edhe ashtu siç propozoi asambleisti Burim Krasniqi.

Kryesuesi: Atëherë, e vendosim në votim propozimin e Burim Krasniqit. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Unanimisht (5) votohet propozimi i Burim Krasniqit, që pika e katërt të tërhiqet nga rendi i ditës.

5. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim asfatshkurtër të pronës komunale, P-00268-1, ZK-Hoçë e Madhe:

Afrim Oruqi: Bëhet fjalë për zonën kadastrale Hoçë e Madhe, ne ju propozojmë juve që të merrni vendim që pjesën e parcelës me sipërfaqe të përgjithshme prej 3 ha, 16 ari e 77m², që prej kësaj pjese ta ndajmë një sipërfaqe prej 40 ari dhe të marrim vendim për dhënien në shfrytëzim për 15 vjet. Saktësisht, kjo parcelë gjendejt në anën e majtë të rrugës Rahovec – Sukarekë dhe është në listën e përgjithshme të pronave që i kemi ideuar për t'i dhënë në shfrytëzim brenda vitit 2024.

Burim Krasniqi: A duhet ndonjë pëlqim prej këshillit të Hoçës së Madhe para se të jepet në shfrytëzim? Meqenëse është zonë kadastrale Hoçë e Madhe!

Afrim Oruqi: Është një hartë e saktë që tregon se cilat parcela i përfshinë zona e mbrojtur dhe jo krejt zona kadastrale në Hoçë të Madhe është zonë e mbrojtur. Kjo pjesë është mbi rrugë dhe nuk është në zonë të mbrojtur, destinimin e pronarit.

Nënkyetari: Në zonë të mbrojtur kryesisht është vendbanimi.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! Nëse nuk kemi pyetje tjera, e vendosim pikën në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë, me 6 vota pro, miratohet pika e pestë. Të nderuar anëtarë të KPF-së, kemi ardhur te dy pikat shtesë.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, P- 002681, zk- Hoçë e Madhe:

Afrim Oruqi: Bëhet fjalë për parcelën e lartëpermendor dhe duhet të formojmë komisionin për zbatimin e procedurave sipas rregullativave ligjore. Komisioni do t'i ketë pësë anëtarë, 2 nga ekzekutivi, 2 nga kuvendi dhe 1 nga sektori joqeveritar.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! Nëse nuk kemi diçka tjeter, e vendosim pikën në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë, me 6 vota pro, miratohet pika e gjashtë. Vazhdojmë me pikën e dytë shtesë.

7. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr. 253/24, i datës 24.09.2024 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale.

Afrim Oruqi: Bëhet fjalë për vendimin që e kemi marrë, për t'i dhënë në shfrytëzim lokalet afariste te stacioni i autobusëve, si dhe vendimin që e kemi formuar komisionit për t'i zhvilluar procedurat për këto lokale. Kjo tokë e komunës, aktualisht është në shfrytëzim te stacioni i autobusëve. Për këtë pikë, vazhdimisht kemi qenë në kontakt me zyrtarët ligjorë të komunës dhe ata të MAPL-së. Jemi në një fazë ku as ata nuk kanë mundur të gjejnë zgjidhje se si të veprojmë tutje. Sipas ligjit, është e ndaluar që ne t'ia japim në shfrytëzim këtë pronë personit të tretë, gjithashtu edhe stacioni i autobusëve që e ka marrë këtë tokë prej komunës, e kanë ndaluar që t'ia japin në shfrytëzim personit të tretë. Ju kërkoj që ta miratoni këtë vendim për shfuqizim dhe në të ardhmen do të mundohemi t'i bëjmë zgjidhje këtij objekti, të ndërtuar nga komuna, në tokën që komuna ia ka dhënë në shfrytëzim stacionit të autobusëve.

Nënkyetari: Në seancën e kuvendit komunal, besoj që zyra ligjore do ta jap opinionin lidhur me këtë shfuqizim.

Leonard Morina: Këtu thotë: Sipas MAPL-së menaxhmineti i ndërmarrjes publike "Stacioni i Autobusëve" menaxhon me këto lokale, sepse ju pronën ia keni dhënë stacionit dhe ndoshta ndërtimin e keni bërë pa u konsultuar me ta, ose faktikisht pa e shikuar ligjin. A keni pasur të drejt të bëni investime?

Isak Hoti: Faleminderit kryesues! I nderuar nënkyetar, të pranishëm. Këtu aksionare 100% është Komuna e Rahovecit. Jo rastësisht, e kemi një komision të formuar që çdo mandat e formojmë komisionin e aksionarëve.

Në këtë rast, nuk kemi pasur nevojë ta pyesim se a dëshirojmë të ndërtojmë diçka, apo jo, sepse prona është 100% e Komunës së Rahovecit. Të njëtin problem që e kemi ne sot, e ka edhe Komuna e Ferizajit. Këto prona, që faktikisht ia kemi dhënë në shfrytëzim bordit të stacionit të autobusëve, ata nuk kanë të drejtë t'i jasin në shfrytëzim, sepse ligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale, i ndalon këto, nëse nuk gaboj nen 6, thotë: nuk kanë të drejtë t'iu jasin në shfrytëzim palëve të treta. Unë kam qenë në kontakt të rregullt me MAPL-në dhe përmoment as ata nuk e kanë një zgjidhje. Besojmë që në seancën e radhës do ta kemi dokumentacionin dhe me MAPL-në do të koordinohemi në mënyrë të mirëfillt.

Defrim Kafexhiu: Inderuar kryesues, drejtor, anëtarë të KPF-së, inderuar Isak, më vjen mirë je mirë me shëndet, pas atij problem shëndetësor. E kam një pyetje: Lokali i stacionit të autobusëve që aktualisht është në shfrytëzim, në qfarë procedure është dhënë? A është e mundshme që në të njëjtën mënyrë të jepen edhe këto lokalet tjera? Apo edhe objekti t'i jepet në shfrytëzim stacionit të autobusëve, përvèç tokës!

Burim Krasniqi: Së pari, çofshin të kaluara! Në seancën e rregullt kam thënë që ndoshta investimi i komunës ka mundur të bëhet në mungesë të kapaciteteve profesionale që i ka brenda stacionit të autobusëve, nuk ka zyrë të prokurimit dhe duhet që komuna t'i ndihmojë për t'i kryer këto procedura. Kam thënë që me procedurat e dhënies në shfrytëzim, asambleja do të jetë jashtë kompetencave të veta, ose në këtë rast komuna. Nuk është që kam ditur ta shpjegoj ashtu siç e ka bërë MAPL-ja, por, konsideroj që, pronën duhet t'ia japim komplet stacionit, që stacioni t'i zhvillojë procedurat, ose ta merrë komuna dhe në vendim për dhënien në shfrytëzim, në njërin prej neveve të shkruhet që të hyrat i inkasohen stacionit të autobusëve me qëllim të përkrahjes për stacionin. Me statutin që e ka, e kam thënë që komuna nuk ka të drejtë ta bëj. Nuk jam jurist, por, po flas nga prej përvojën në administratë.

Isak Hoti: Faktikisht, problemi nuk është te stacioni i autobusëve, por është tek ne. Në qoftëse, ata e jasin në shfrytëzim, nuk kemi "qare" pa reagu, ose dikush nga kuvendarët do të reagojë, duke thënë që a kanë të drejtë që ata t'i jasin në shfrytëzim palës së tretë? Jo, sepse ligji decidivisht e ndalon. Këtu është dilema dhe jo rastësish ka mospërputhje të ligjeve. Jemi duke u mundur ta gjejmë një rrugë të përbashkët.

Kryesuesi: Faleminderit z. Isak Hoti! Në qoftëse e kemi përfunduar me diskutime, këtë pikë e vendosim në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë, unanimisht me 6 vota pro, miratohet pika e shtatë.

8. Të ndryshme:

Defrim Kafexhiu: E kam një kërkesë! I kam përgatitur disa pyetje që kam dashur t'i bëj këtu në KPF, për Drejtorinë e Shëndetësisë, Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Drejtorinë e Urbanizmit, Drejtorinë e Ekonomisë dhe Drejtorinë e Inspepcionit, por fatkeqësisht drejtorat nuk janë të pranishëm këtu. Po më vjen keq që po keqpërdorohet edhe mundi edhe koha e anëtarëve të KPF-së në këtë rast. Tre drejtorë janë këtu, mund të themi që janë të përgjegjshëm, por edhe pika e tyre janë pjesë e diskutimeve këtu dhe kjo nuk do të thotë që drejtorat tjerë mos të marrin pjesë. Ne mund mos t'i kalojmë pikat dhe ta ndryshojmë rendin e ditës në KPF, por, pastaj po e hudhni gurin në një anë tjetër. Drejtorat janë shumë të papërgjegjshëm. Një pyetje e kam nënkyetar: Në qfarë forme u është dhënë në shfrytëzim, shtëpia e të moshuarve shoqatës "Hareja" dhe a është duke funksionuar?

Nënkyetari: Faleminderit inderuar kryesues! Të inderuar anëtarë të KPF-së, drejtorë dhe gjithë ju të pranishëm. Një gabim gjuhësor, nuk thuhet "keqpërdorohet" po thuhet "keqpërdoret". As unë nuk jam gjuhëtar, as ti! Secili drejtor i ka punët e veta dhe është me rëndësi që këta që i kanë pikat e rendit të ditës janë të pranishëm. Në momentin që drejtorët tjetër nuk janë të pranishëm, është nënkyetari, kur nuk është nënkyetari, sigurisht që është kryetari. Mundësitet përgjigje janë edhe me shkrim dhe gojarisht. Sa i përketë papërgjegjshmërisë së tyre ne do t'i njoftojmë dhe kur janë pa obligime në drejtoritë e tyre besoj që do të jenë këtu, në anën e kundërt të juajin edhe një kohë të gjatë pas vitit 2025, ndoshta të njëjtë jo, por të akronimit politik sigurt që po. Sa kam unë info, forma e shfrytëzimit të shtëpisë për të moshuarit është një memorandum me organizatën "Hareja". Nuk jam i sigurtë, sepse kam munguar disa ditë aty. Sido që të jetë, është ligjërisht e rregulluar dhe besoj që do të jetë një menaxhim i mirë sa i përket ofrimit të shërbimit për këtë kategori që deri dje i ka munguar komunës tonë.

Skender Hamza: Përshëndetje kryesues, nënkyetar, asambleistë, kolegët nga zyra për informim dhe zyra ligjore. Si sekretari e kuvendit ju kemi dërguar disa emala në lidhje me publikimin e CV-ve. Kemi rekomandim dhe vërejtje që ende nuk i kemi të publikuara të gjithë. Ju lus që brenda kësaj jave t'i dërgoni dhe t'i publikojmë në ueb-faqë të komunës.

Burim Krasniqi: A është obligim ligjor publikimi i CV-së? Kur i kemi parasysh ministritë, ka ministër që nuk ka CV të publikuar. Nëse nuk është obligim ligjor, është vullnet i secilit nga ne. Nëse nuk është obligim ligjor, nuk jam i gatshëm për ta dërguar.

Skender Hamza: Obligim ligjor ndoshta jo, por neve na duhet për performancë komunale.

Nënkyetari: Kjo është për performancë komunale, jo performancë e Smajl Latifit.

Kryesuesi: Nëse një qytetarë hyn në ueb të komunës, do t'i ketë të dhënë tuaja. Ju falënderoj të gjithëve përvëmendje. Shihemi në mbledhjet e radhës.

Procesmbajtësi;

Albion Krasniqi

